



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0364

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim, Kimete Gashi-Brajshori dhe Vedat Poterqoi duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) TETRONIKS L.L.C., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me kamera servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sigurisë dhe kamerave në ndërtesat qeveritare me numër të prokurimit 214-25-1747-1-1-1, me 17/07/2026, mori:

Vendim

- 1.Përfundon procesi i shqyrtimit administrative i filluar sipas ankesës së operatorit ekonomik “TETRONIKS” L.L.C. me nr. 2026/0364 , e datës 05/06/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kamera servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sigurisë dhe kamerave në ndërtesat qeveritare”, me numër të prokurimit 214-25-1747-1-1-1. (Jashtë juridiksionit)
- 2.Ankuesi lidhur me këto veprime të AK rreth anulimit aktivitetit te prokurimit ne kundërshtim me ligjin, mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente për mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.
- 3.Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.03.2025 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me kamera servisimi dhe mirembajtja e pajisjeve te sigurise dhe kamerave ne ndertesat qeveritare” me nr. të prokurimit: "214-25-1747-1-1-1".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 600,000.00 €.

Me 21.05.20206 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi anulimin (B10), ku është anuluar aktiviteti.

Me datën 21.05.2026 AK-ja ka publikuar B10 Njoftimi per anulimin e aktivitetit te prokurimit

Me 26.05.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku AK nuk ka dhënë përgjigje.

Me 05.06.2026, OE TETRONIKS L.L.C., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0364, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder anulimit të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Administrata e OSHP-së ka konstatuar se ankesa pas analizimit nga zyra e pranimi në pajtim me nenin 13, 14 si dhe nenit 17 të Rregullores nr. 01/2020, si dhe bazuar në nenin 109 të LPP-së, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marr nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtroj ankese në OSHP, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjedhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Po ashtu, parashtruesi i ankesës e ka statusin e palës se interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1.26 i LPP-së, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111 të LPP-së, që do të thotë se i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave ligjore të cituara dhe bie nën kompetencat e këtij organi OSHP. Lidhur me këtë ankesë pas analizimit nga zyra e pranimi në pajtim me nenin 13, 14 si dhe nenit 17 të Rregullores nr. 01/2020, si dhe bazuar në nenin 109 të LPP-së, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marr nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtroj ankese në OSHP, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjedhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Po ashtu, parashtruesi i ankesës e ka statusin e palës se interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1.26 i LPP-së, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111 të LPP-së, që do të thotë se i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave ligjore të cituara dhe bie nën kompetencat e këtij organi OSHP, mirpo për Panelin Shqyrtues konsiderohet se ankesa e parashtruar është në kundërshtim me nenin 10 par 3 i LPP-së

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues TETRONIKS L.L.C., janë parashtruar si në vijim:

Me datën 25.04.2025 është bërë dorëzimi i tenderit në platformën e E-Prokurimit, përderisa B12 Procesverbali i Hapjes së Tenderëve është ngarkuar në po të njëjtën datë në orën 15:19.

Me datën 20.06.2025 kemi pranuar nga AK-ja letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Pas kërkesës B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, kemi bërë dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar sipas kriterëve të pranueshmërisë së OE-së në DT dhe me datën 04.07.2025 kemi pranuar B08 Njoftimin për dhënie të kontratës. Kompania jonë është shpallur si tenderues i përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe e përzgjedhur për kontratë. Nga kjo datë është bërë disa herë zgjatja e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit.

Draftin e kontratës AK-ja e ka ngarkuar në platformën e E-Prokurimit me datën 09.07.2025, të cilën ne si OE e kemi aprovuar.

Nga kjo datë, AK-ja më nuk ka informuar mbi kohën dhe ecurinë e nënshkrimit të kontratës, edhe përkundër kërkesave tona të kohëpaskohshme për nënshkrimin e kontratës.

Me datën 21.05.2026, AK-ja përmes platformës së E-Prokurimit dërgoi B10 Njoftimin për Anulimin e aktivitetit të prokurimit, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenit 26 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Procedura e prokurimit është zhvilluar dhe përfunduar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, ku:

është marrë vendimi për dhënie të kontratës;

kanë përfunduar afatet ligjore për ankesa;

nuk ekziston asnjë vendim pezullues nga OSHP apo organ tjetër kompetent; draft-kontrata është përgatitur dhe dërguar për aprovim; ne si OE kemi përmbushur të gjitha kushtet ligjore dhe kontraktuale të kërkuara.

ANKESA

1. Anulim i paligjshëm – Shkelje e nenit 62 të LPP-së

Neni 62 i LPP-së lejon anulimin e një aktiviteti të prokurimit vetëm para dhënies së kontratës ose në rrethana të përcaktuara ngushtë. Pas dhënies së kontratës, skadimit të afatit të ankesave dhe krijimit të kontratës, anulimi është i paligjshëm. Duke e anuluar dhjetë muaj pas dhënies së kontratës, AK-ja ka vepruar në shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 62 të LPP-së.

2. Zbatim i gabuar i nenit 26 të LPP-së

Neni 26, paragrafi 2, rregullon nënshkrimet e kërkuara për vlefshmërinë ligjore të kontratave. Ky nen nuk autorizon anulimin e një aktiviteti prokurimi pas dhënies së kontratës. Duke përdorur këtë dispozitë si bazë për anulim, AK-ja ka zbatuar gabimisht ligjin dhe në mënyrë arbitrare, duke bërë shkelje të nenit 26 të LPP-së.

Dispozitat juridike që rregullojnë procedurën e prokurimit publik nuk parashohin si arsye ligjore për njoftimin e anulimit të prokurimit (pas shpalljes së fituesit) faktin e mosnënshkrimit të kontratës nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), apo Ministri përkatës. Në njoftimin e pranuar, si arsye e anulimit konstatohet mosplotësimi i kërkesës së paragrafit 2 të nenit 26 të LPP-së. ZKA-ja apo Ministri përkatës mund të refuzojnë nënshkrimin e kontratës vetëm në rastet e parapara me ligj, kur nuk është respektuar ndonjë dispozitë ligjore, por që në rastin konkret, në bazë të njoftimit të pranuar, nuk rezulton se të njëjtit kanë refuzuar nënshkrimin e kontratës për shkak të konstatimit të ndonjë shkeljeje të caktuar të procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, aktiviteti i prokurimit është anuluar pa asnjë shkak dhe pa bazë ligjore, në mënyrë arbitrare, prandaj si i tillë, njoftimi i marrë është në kundërshtim me Parimin e Ligjshmërisë dhe Parimin e Pritshmërisë. Dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e prokurimit nuk i japin askund të drejtë ZKA-së apo Ministrisë përkatës që të refuzojnë dhe të mos nënshkruajnë kontratën publike në rastet kur nuk konstatohet ndonjë shkelje ligjore gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit publik. Pra, nuk ka dispozitë ligjore që ia mundëson AK-së anulimin e aktivitetit të prokurimit kur, pa asnjë arsye ligjore, ZKA-ja dhe Ministri përkatës nuk e nënshkruajnë kontratën. Prandaj, njoftimi dhe vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit publik është arbitrar dhe i paligjshëm.

3. Ka cenuar qëllimin e LPP-së – neni 1

Ky vendim për anulimin e procedurës, me qëllim të bllokimit të kontratës pa bazë konkrete, ka cenuar sigurinë juridike dhe ka krijuar pasiguri juridike, duke dëmtuar integritetin e prokurimit publik.

4. Shkelja e parimeve të përgjithshme – neni 7 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së përcakton parimet udhëheqëse të prokurimit: transparencën, trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, proporcionalitetin dhe sigurinë juridike. Duke zvarritur nënshkrimin e kontratës për më shumë se dhjetë muaj dhe më pas duke e anuluar atë, AK-ja ka cenuar:

sigurinë juridike, pasi dhënia e kontratës dhe pritja për nënshkrim krijuan pritshmëri legjitime;

transparencën dhe trajtimin e barabartë, duke qenë se anulimi nuk bazohej në ndonjë shkak të ligjshëm, por në vetë dështimin administrativ të AK-së.

Konsiderojmë se ky veprim përbën shkelje të parimeve të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, tejkalim të autorizimeve ligjore dhe cenim të së drejtës sonë si OE që të fitojmë, përmes një procedure kontraktuale të ligjshme, kontratën e prokurimit publik.

5. Përgjegjësia për dëmet

Mosveprimi i AK-së dhe refuzimi arbitrar i nënshkrimit të kontratës përbën akt administrativ të kundërligjshëm që na ka shkaktuar dëm neve si OE, duke krijuar bazë për kompensimin e shpenzimeve dhe fitimit të humbur sipas dispozitave të LMD-së Nr. 04/L-077 dhe legjislacionit për mbrojtje juridike në prokurimin publik. Si pasojë e anulimit të paligjshëm, kompania jonë ka pësuar shpenzime dhe ka humbur fitimin që do të gjenerohej nga ekzekutimi i kontratës.

Kemi kërkuar nga AK-ja që të marrë për bazë faktet dhe argumentet e cekura më lart, të cilat dëshmojnë qartazi shkeljet e dispozitave të LPP-së, të bëjë anulimin e vendimit të Njoftimit për Anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe të vazhdojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës, ndërsa AK-ja ka zgjedhur heshtjen administrative, duke mos kthyer përgjigje, në kundërshtim me dispozitat ligjore që dalin nga LPP-ja.

Andaj, jemi të obliguar të procedojmë tutje me ndjekjen e masave ligjore, me ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, konform nenit 108/A të LPP-së, duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të sjellë vendim meritore me të cilin obligon AK-në që:

të anulojë njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit;

të urdhërojë AK-në të procedojë tutje dhe pa vonesë me nënshkrimin e kontratës.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10.06.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0364, ndërsa me datë 19.06.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0364, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e TETRONIKS L.L.C., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0364 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me Vendimin e AK-së në lidhje me këtë procedurë të prokurimit. Pretendimet e ngritura ankimore janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

“Procedura e prokurimit është zhvilluar dhe përfunduar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, ku:- është marrë vendimi për dhënie të kontratës- kanë përfunduar afatet ligjore për ankesa- nuk ekziston asnjë vendim pezullues nga OSHP apo organ tjetër kompetent- draft-kontrata është përgatitur dhe dërguar për aprovim - ne si OE kemi përmbushur të gjitha kushtet ligjore dhe kontraktuale të kërkuar. AK-ja më nuk ka informuar mbi kohën dhe ecurinë e nënshkrimit të kontratës edhe përkundër kërkesave tona të kohëpaskohshme për nënshkrimin e kontratës. Pas dhënies së kontratës, skadimit të afatit të ankesave dhe krijimit të kontratës, anulimi dhjetë muaj pas dhënies së kontratës është i paligjshëm, AK-ja ka vepruar në shkelje të drejtëpërdrejtë të Nenit 62 të LPP-së.”

Përgjigje

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin e ngritur sqaron kronologjinë e mbarëvajtjes së këtij aktiviteti:

Me datë 13/03/2025, AK ka publikuar njoftimin për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit;

Me datë 25/04/2025, AK ka bërë hapjen e ofertave duke publikuar edhe procesverbalin e hapjes së tenderëve;

Me datë 20/06/2025, AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së përmes të cilit sqarohet se autoriteti kontraktues shpërblen me kontratë OE ankues- Tetroniks;

Me datë 04/07/2025, AK ka publikuar formularin B08- Njoftimin për dhënie të kontratës;

Me datë 11/07/2025, AK përmes sistemit e-prokurimi ka dërguar për aprovim tek OE ankues draftin e kontratës për aprovim;

Me datë 21/05/2026, sipas e-prokurimit AK publikon formularin B10- Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit përmes të cilit autoriteti dhjetë (10) muaj pas dërgimit për aprovimin e draft-kontratës anulon këtë aktivitet me arsyetimin se citim: “Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenin 26 të Ligjit të

Prokurimit Publik.”;

Sqarojmë që gjatë kësaj periudhe prej dhjetë (10) muajsh që nga publikimi i draft-kontratës e deri në publikim të formularit B10 nga ana e AK-së, operatori ekonomik ka sqaruar që disa herë ka bërë kërkesa për nënshkrimin e kontratës mirëpo që sipas tyre asnjëherë nuk janë informuar rreth kohës apo ecurisë për nënshkrimin e kontratës. Kjo gjë vërtetohet edhe përmes sistemit ku shihet se OE me datë 21/11/2025 ka dërguar kërkesë për sqarimin e vonesës së nënshkrimit të kontratës.

Pas kësaj situate, Autoriteti Kontraktues vetëm pasi kanë kaluar dhjetë (10) muaj pas publikimit të draft-kontratës ka publikuar njoftimin për anulimin e kësaj procedure (Formulari B10) sipas arsytimit të dhënë më sipër ku eksperti shqyrtues sipas mendimit të tij sqaron që ky arsyetim i dhënë nuk është aspak i qartë sepse nuk tregon saktësisht arsyet se përse nuk janë përmbushur kushtet sipas paragrafit 2 të nenit 26 të Ligjit për Prokurimin Publik. Pra, sipas mendimit tonë ky njoftim për anulim nuk përmban arsyetim konkret mbi ekzistimin e ndonjë shkeljeje procedurale, ndryshim të nevojave të AK-së apo ndonjë rrethanë tjetër objektive që do të justifikonte nga ana e tyre anulimin. AK nuk ka ofruar asnjë dëshmi konkrete që sipas nenit 26, paragrafi 2 i LPP-së, kush nga personat e përfshirë në këtë paragraf ka refuzuar nënshkrimin e kontratës dhe në bazë të cilit arsyetim.

Në rastin e tillë sipas mendimit tonë vlerësojmë që AK në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit nuk ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme ekzistimin e arsyeve apo rrethanave ligjore që do ta bënin të pamundur lidhjen e kontratës, tashmë e publikuar në e-prokurimi. Për më tepër, edhe pse OE ankues me datë 26/05/2026 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, kjo kërkesë sipas të dhënave në sistem nuk duket se është shqyrtuar nga ana e autoritetit kontraktues e që sipas nenit 108/A të LPP-së, AK duhet të jap përgjigje sipas afatit të paraparë për çdo kërkesë për rishqyrtim e cila parashtrohet nga ana e operatorëve ekonomik.

Në anën tjetër nëse AK paraqet dëshmitë konkrete me shkrim që një apo më shumë persona sipas nenit 26 të LPP-së refuzojnë të nënshkruajnë kontratën për arsye të caktuara ligjore atëherë sqarojmë që në rastin e tillë ne si ekspert shqyrtues nuk kemi kompetencë që të zëvendësojmë diskrecionin ligjor të organit kompetent dhe as nuk mund të urdhërojmë nënshkrimin e kontratës nëse kushtet ligjore për lidhjen e saj nuk janë plotësuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit

lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me kamera servisimi dhe mirembajtja e pajisjeve te sigurise dhe kamerave ne ndertesat qeveritare” me nr. të prokurimit: "214-25-1747-1-1-1".

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-shqyrtim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues analizoj në tërësi aktivitetin dhe sipas të dhënave në platformën e e-prokurimit fillimisht AK ka publikur B08 Njoftim për dhënie të kontratës me datën: **04.07.2025**, ndësa më pas ka bërë publikimin e B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 21.05.2026, lidhur me aktivitetin me titull “Furnizimi me kamera servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sigurisë dhe kamerave në ndërtesat qeveritare me numër të prokurimit 214-25-1747-1-1-1” për çka AK ka inicuar procedurën të hapur për furnizim. Në njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit vëren se në faqën 3 , rubrikën IV.3) ka paraqitur “Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik: Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”, dhe V.2) INFORMACIONET SHITESË citohet “ *Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenin 26 të Ligjit të Prokurimit Publik*”

Paneli shqyrtues ka evidentuar dispozitat ligjore për prokurim publik që kanë ndërlidhje me këto veprime të AK Pasi që neni 62 i LPP-së mjaftë qartë precizon se në cilat raste mund të përfundoj aktiviteti i prokurimit,, po ashtu Rregullorja për Prokurim Publik neni 43, përcaktohen rastet se kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës së prokurimit, ndërsa, arsyeshmëria e AK për ndërprerje të kësaj procedure, anulimin e këtij aktiviteti nuk parashihet në këtë dispozitë, ngase AK është i obliguar të veproj konform dispozitave ligjore ta bëjë ligjshmërinë e secilit veprim dhe këto të verifikohen para inicimit të aktiviteti të prokurimit por edhe në fazat e më të vonshme, ndërsa, jo në fazën kur publikohet njoftimi për dhënie të kontratës (B08) kur pritët të bëhet edhe nënshkrimi i kontratës nga palët.

Me publikimin e njoftimit mbi dhanje të kontrates (B08) , sikurse kjo procedur e inicuar nga AK-ja për Panelin Shqyrtues konform dispozitave ligjore konsiderohet aktivitet i mbyllur ashtu siç e përcakton edhe neni 10 paragrafi 3, pika (i) i LPP, citat "aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit" si dhe nenin 42.4 të RRPP nr.001/2022. Në nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, e obligon AK që, citat: "Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj atë brenda 30 ditëve kalendarike", ashtu sikurse e obligon edhe neni 24, paragrafi 2 i LPP " *Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj*".

Andaj, Paneli Shqyrtues bazuar në nenin 10 të LPP-së , lidhur me nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, vlerëson se kjo çështje është përfunduar dhe rrjedhimisht vendosi si në pikën 1 të dispozitivit. Kurse ankuesi për realizimi e të drejtës së tij/saj mund ti drejtohet institucioneve kompetente. Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e

ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se shqyrtimi i kësaj ankesë bie jashtë autorizimeve të përcaktuara ligjore.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kompetente në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - TETRONIKS L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: